



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.105, datë 23.05.2023

PËR

“MIRATIMIN E OPINIONEVE PËR KANDIDATËT QË KANË APLIKUAR NË
PROCEDURËN E KOMANDIMIT PRANË EUROJUST”

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 53, pika 2 dhe nenin 54, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 5 të ligjit Nr.113/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST”, nenin 164, pika 8, nenin 166, pika 2, nenin 176 pika 3, nenin 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e opinioneve për prokurorët Alma Bramo, Denisa Asko, Ervisa Hyka dhe Fatjona Memçaj, kandidatë për t’u komanduar pranë Eurojust.
2. Të njoftohet me këtë vendim dhe opinionet bashkëlidhur, kandidatët e mësipërm dhe Prokurori i Përgjithshëm.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
4. U shpall në Tiranë, sot më 23.05.2023.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË


KRYETAR
Alfred Balla

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Eloida Goxhi

ANËTAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Bujar Sheshi

ANËTAR
Esmeralda Keshi

ANËTAR
Arta Mandro

ZV/KRYETAR
Tartar Bëzaj

ANËTAR
Nurihan Seiti

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Ledina Riza